



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 24

Datë: 13. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 22 dhe 23/2024**
3. **Raport i Këshillave të KQZ**

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të votimit dhe numërimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Formave Zgjedhore, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
4. 4. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, tha fillimisht se në këtë mbledhje mungojnë me arsye anëtarët Ilir Gashi dhe Čemailj Kurtiš, të cilët nuk do të marrin pjesë. Ai pastaj, paraqiti agjendën e takimit. A ka ndryshime, propozime ?

Arianit Elshani, propozoi një pikë: zëvendësimin e anëtarit të KKZ në Mitrovicën e Veriut, dhe një pikë tjetër "Njoftim" lidhur me përzgjedhjen e televizionit, radios lokale dhe portaleve për publikimin e materialeve për procesin e votimit, dhe shqyrtimin dhe miratimin e numrit të Fletëvotimeve në Vendvotime.

Sami Hamiti, propozoi kërkesën për rend dite: Zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Kaçanikut.

Gjithashtu, një pikë shtesë u propozua edhe nga Beznik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP.

Me 9 vota për, u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, u miratuan procesverbali nr. 22 dhe nr. 23/2024. Procesverbali nr. 23, u miratua me 1 vërejtje nga kryetari Radoniqi rreth formulimit të agjendës së miratuar të kësaj mbledhje. Me 9 vota për, u miratuan edhe këto dy procesverbale.

2. Aktivitetet e ZRCKFSP

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës tha se, se gjatë periudhës 9 - 12 prill kanë aplikuar 12 organizata me 109 vëzhgues. Zyra, ka shqyrtuar aplikimet. Këto aplikacione ne kemi konsideruar i plotësojnë kriteret për akreditim. Ky është grupi i dytë, dhe ne rekomandojmë për akreditim.

Pas prezantimit të raportit me 9 vota për, u akreditua grupi i dytë i vëzhgueseve të 12 organizatave, me 109 vëzhgues.

3. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të votimit dhe numërimit, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se KOZ-i e ka shqyrtuar këtë pikë dhe se, përmes procedurave shpjegohet i gjithë përgatitjeve të VV-e, i procesit të votimit, i hapjes, i procedurave të numërimit në Vendvotim. Ky dokument, tha në vijim z. Elshani, është përditësuar vazhdimisht nga KOZ për shkak të rregullave të reja, dhe procedurave në vendvotim, përdorimit të kamerave, dhe ndryshimeve të tjera etj. Ne, rekomandojmë për miratim, tha në fund z. Elshani.

Me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), u miratuan procedurat e votimit dhe numërimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve në komunat veriore.

Shqyrtimi dhe miratimi i Formave Zgjedhore, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe dizajnin e formave zgjedhore, duke marrë parasysh se ky proces po ndodh për herë të parë. Pra, mënyra e votimit ndryshon nga proceset e rregullta zgjedhore, dhe është dashur që të bëhen të gjitha shqyrtimet e këtij procesi. Çdo gjë, është konform rregullave të reja... Ju, tha z. Elshani i keni pasur raportet, format zgjedhore në imell...

Me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), u miratuan Format Zgjedhore.

Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Në vazhdim, z. Arianit Elshani tha se është shqyrtuar edhe nominimet e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve nga subjektet politike. Në komunën e Laposaviqit janë 83 nominime, në komunën e Zubin Potok 72 nominime, në Zveçan 37 nominime dhe në Mitrovicën e veriut 87 nominime.

Kemi kërkuar që Sekretariati dhe KKZ-të për shtimin e numrit të anëtarëve. Pra, të plotësohet numri prej 5 anëtarëve, dhe kjo është brenda kornizave të ligjshme. Pra, rekomandojmë të miratohen këto nominime.

Me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), u miratuan Këshillat e Vendvotimeve.

Njoftim lidhur me produktet e Informimit Publik:

Arianit Elshani, tha janë shqyrtuar edhe produktet e Informimit Publik për personat me nevoja të veçanta, si të plotësohet Fletëvotimi, videomaterialet. Janë identifikuar portalet dhe mediat ku janë publikuar, por vetëm aty ku produktet janë edituar pa pagesë. Nga dita e hënë, produktet të lansohen edhe në mediat lokale, portalet, televizionet...

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KKZ në Mitrovicën e Veriut:

Z. Elshani e informoi KQZ-në edhe për shqyrtimin e kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të KKZ në Mitrovicën e Veriut nga subjekti GSPO që ka dhënë dorëheqje, dhe zëvendësimi bëhet nga po ky subjekt. Janë plotësuar kushtet, dhe ne rekomandojmë për miratim.

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të Fletëvotimeve në Vendvotime:

Arianit Elshani tha se, KOZ-i ka shqyrtuar edhe rekomandimin e numrit të Fletëvotimeve në Vendvotime. Si zakonisht, ne shtypim gjithmonë më pak fletëvotime se numri i votuesve. KQZ, rekomandon se sasia është 14% më pak. Kjo, është praktikuar edhe emë herët... Por, ne do të kemi fletëvotime rezervë. Në këtë proces, do të shtypen 39, 200 fletëvotime nga numri total i votuesve prej: 46 556 votues.

Sami Hamiti: Ne, u dakorduar por kam drojë se mos po e zvogëlojmë shumë... Se, mos dalin më shumë, bie fjala se 85% se, e kemi këtë fakt në vitin 2021. Mos po mbesim pa fletëvotime...

Pas shpjegimit të z. Elshani se, pse është vendosur kështu, me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), u miratua numri i Fletëvotimeve që do të shtypen për këtë proces votimi.

4. Këshilli për Cështje Ligjore

Shqyrtimi dhe zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit Komunal:

Sami Hamiti, tha se këshilli e ka shqyrtuar një kërkesë për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Kaçanikut. Janë shqyrtuar të gjitha kushtet ligjore, dhe ne rekomandojmë që Burim Shehu nga Lëvizja “Vetëvendosje!” ta zëvendësoj anëtarin e deritashëm, Adnan Reka.

Me 9 vota për, u miratua ky rekomandim.

Të ndryshme!

